



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primihera Mëi Dana 01.07.2024			
Nr. i organit Org. broj	Numri i Dëronj	Shtetësi Prilog	Vlera Vlerësues
01-	110/05-	922	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 24, paragrafi 1,2 dhe 25, paragrafi 1,2 dhe 6 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03, prill 2019), kërkesë nga Ministria për Administratë të Pushtetit Lokal e datës 21.02.2024, me Nr.020-100/2, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.06.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për plotësimin e Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për plotësimin e Vendimit Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.

Neni 2

Qëllimi i plotësimit të Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 30.01.2024 është bërë me kërkesën e Ministrisë për Administratë të Pushtetit Lokal, e datës 21.02.2024, me Nr.020-100/2 ministria ka kërkuar nga Komuna e Vitisë harmonizimin e Vendimit 01-060/01-116, të datës 30.01.2024 me dispozitat e Ligjit të Zbatueshëm Nr.06/L092 dhe Rregulloren QRK Nr.09/2020 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, e cila ka kërkuar vlerësimin financiar të pronave të paluajtshme të cilat janë objekte të këmbimit

Neni 3

Plotësimi i vendimit bazë ka të bëjë me përfshirjen e raportit të vlerësimit me Nr.021/463, Nr.refer.102-1/2024, i datës 17.05.2024 vlerësuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere të Republikës së Kosovës, për vlerën e tregut të pronës së paluajtshme të komunës dhe vlerësimi i pronës private ashtu siç është kërkuar nga Ministria për Administratë të Pushtetit Lokal.

Neni 4

Të gjitha pjesët tjera të Vendimit me Nr.01-060/01-116, të datës 01.02.2024 për këmbimin e pronës së palujtshme komunale me pronat e palujtshme në pronësi të pronarëve Kadri (Bislim) Emërllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti mbeten në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadaster;
3. Palëve

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi

